

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR SHPALLJEN E MORATORIUMIT NË PYJE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për shpalljen e moratoriumit në pyje ne Republikën e Shqipërisë” përbën një nismë ligjore të rëndësishme në fushën e pyjeve dhe kullotave në Republikën e Shqipërisë. Ky projektligj ka për qëllim të reduktojë ndërhyrjen mbi fondin pyjor me synim përmirësimin dhe rehabilitimin e gjëndjes së tij, zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave, si pasuri kombëtare me rëndësi të veçanta, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës dhe tokës, në ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhues, ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

Nevoja për këtë akt doli për shumë arsye dhe këtu mund të përmendim faktin që sasia e materialit drusor të shfrytëzuar që prej vitit 1945 e deri sot është 2-3 herë më e lartë sesa rritja vjetore natyrore e pyjeve. Prerjet masive ilegale pas viteve 1990 ishin në nivele shumë të larta se mundësia fizike e pyllit për tu rivitalizuar. Nga viti 2004 deri në 2015 raportohen prerje ilegale me mbi 2,500,000 m³ në vit. Pasojat e këtyre prerjeve bëjnë që vetëm për periudhën 2007-2013 rezulton të kemi pasur një katastrofë të vërtetë mjedisore në sektorin e pyjeve. Janë prerë dhe djegur qëllimisht rreth 17% e fondit pyjor. Po në këto vite 2007–2013, Qeveria Shqiptare dha leje për ndërtimin e plot 435 HEC-ve. Këto HEC-e shpyllëzuan sipërfaqe të konsiderueshme pyjore dhe subjektet nuk patën asnjë marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit për rehabilitimin e tyre. Ndërkohë që sipërfaqja e pyllëzuar në total, nga 1990 deri në 2013 është në nivele të papërfillshme prej 2,678 ha pyllëzim. Pra, vetëm 116 ha/vit. Impakti në mjedis është pothuajse inegzistent.

Sipërfaqja e pyjeve në rang vend në 10 vite nga 2002 deri në 2012 ka pësuar një rënie drastike me më shumë se 14%,

Akti i propozuar parashikon pezullimin 10 vjeçar të shfrytëzimit të pyjeve publik/privat dhe tregtimit të produkteve të saj dhe ndalimin e eksportit të lëndës së drurit të papërpunuar, si e vetmja mundësi për t'i lënë një trashigimi në këtë sektor brezave që do të vijnë.

Më poshtë po paraqesim një informacion mbi sipërfaqet e fondit pyjor në vënd sipas inventarit të paazhornuar që disponon Ministria e Mjedisit:

Nr.	Zëri kadastral	Sip/Ha	Në %
1	Pyje	1,052,771.9	60.5
2	Kullota	478,291.6	27.5
3	Sipërfaqe me bimësi pyjore	25,315.1	1.4
4	Siperfaqe inproduktive	131,194.41	7.5
5	Djerr	54,116.06	3.1
	Gjithsej	1,741,689.0	100

Fondi Pyjor Kombëtar, sipas këtij kategorizimi zë 60.5% të totalit, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 1 052 772 Ha.

Nëse i referohemi formës së pronësisë aktuale (kadastra pyjore 2014), pyjet kategorizohen në tre forma pronësie:

1. Pyje Shtetërorë
2. Pyje Komunalë
3. Pyje Privatë

Sipërfaqja sipas formës së pronësisë është si më poshtë:

Viti	Pyje shtetërorë		Komunalë		Privatë		Gjithsej	
	në Ha	në %	në Ha	në %	në Ha	në %	në Ha	në %
2014	501,126	47	522,867	50	28,780	3	1,052,772	100

Gjatë viteve 2000-2015 janë dhënë mbi 2,700 leje për shfrytëzimin e materialit drusor nga pyjet. Në 2 vitet e fundit (2014-2015) janë dhënë në total vetëm 24 leje për shfrytëzimin e pyjeve, nga ku 9 nga këto për pyje private dhe 15 për pyje shtetërorë. Ndërkohë, vetëm gjatë viteve 2005-2015 është shfrytëzuar një volum i përgjithshëm prej 1,313, 288 m³.

Të dhënat për shfrytëzimin e pyjeve (sasinë e materialit drusor) nga viti 2005 – 2015 janë si më poshtë:

Nr	Viti	Volumi i shitur (në m ³)
1	2005	107,958
2	2006	119,208
3	2007	194,622
4	2008	123,299
5	2009	192,831

6	2010	117,063
7	2011	128,853
8	2012	118,938
9	2013	145,867
10	2014	51,940
11	2015	12,709
TOTALI		1,313,288

Theksojmë se këto të dhëna janë të bazuara mbi kontratat ligjore të lidhura me subjektet private për shfrytëzimin e pyjeve, ndërsa në fakt shfrytëzimi real i pyjeve ka qenë disa herë më i madh për shkak të prerjeve ilegale. Ashtu sikurse shihet nga të dhënat e tabelës nr.5, volumi total i shfrytëzuar gjatë viteve 2005-2015 është 1,313,288 m³(metër kub).

Zonaliteti i shfrytëzimeve ka një shtrirje thuajse uniforme në të gjithë territorin e Republikës, por volumi i hequr është më i madh në pjesën veriore të tij.

Përdorimi i fondit pyjor, përveç shfrytëzimit dhe sigurimit të lëndës drusore, vitet e fundit është rënduar së tepërmi nga konçensionet energjitike dhe ato minerare. Nga konçensionet për ndërtime të HEC-eve llogariten të hiqen dhe/ose merren në përdorim një sipërfaqe pyjore prej 17,800 Ha.

Ndërkohë, nga konçensionet për shfrytëzimin e mineraleve, kryesisht ato me karriera gurore në sipërfaqe, janë miratuar për t'u hequr nga fondi pyjor 40 km², ose 4,000 ha. Këto kërkesa vinë si detyrim për zbatim në Ministrinë e Mjedisit pasi subjektet janë të pajisura me të gjitha lejet e nevojshme nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Vetëm gjatë viteve 2007-2013 është përfunduar procesi i heqjes nga fondi pyjor të mbi 3,000 ha pyje, për qëllime të ndërtimit të HEC-eve.

Vendet e rajonit duke shfrytëzuar tranzicionin e tejzgjatur të vendit tonë kanë gjetur treg të përshtatshëm për të importuar drejt ekonomive të tyre sasi të konsiderueshme material drusor. Llojet e eksporteve kanë konsistuar kryesisht në dru zjarri, qymyr si dhe lëndë drusore e përpunuar e tipit elementë, paleta dhe pellet. Në vitin 2014, duke parë problematikën e krijuar dhe defiçitin e lëndës drusore në vend, Ministri i Mjedisit me Urdhër "Për ndalimin e eksportit të qymyrit të drurit dhe procedurat për eksportin e druve të zjarrit dhe lëndës drusore", ndaloi plotësisht eksporti i qymyrit të drurit dhe u kufizua eksporti i druve të zjarrit vetëm për pyjet privatë dhe subjektet që kishin kontrata 10-vjeçare të shfrytëzimit. Gjatë viteve 2010 deri në vitin 2015, rezultoi të jenë eksportuar nga vendi ynë një sasi prej 388,015 m³ dru zjarri dhe 18,681 ton qymyr druri.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Situata aktuale e fondit pyjor e kullosor në vendin tonë, lë për të dëshiruar dhe e kërkonte një vendimarrje të kësaj natyre. Ndërhyrjet pa kriter dhe prerjet e vazhdueshme të pyjeve kanë sjellë një situatë në kufijtë e emergjencës sa i takon kësaj pasurie natyrore me vlera jetike për jetesën dhe të ardhmen e çdo qytetari në Republikën e Shqipërisë. Me përmirësimet e herë pas herëshme në legjislacion për marrjen e masave të vendosjes dhe rregullave dhe detyrimeve ligjore, gjendja ka pësuar përmirësime në drejtime të ndryshme, si p.sh ndalimi i eksportit të lëndës drusore të papërpunuar, vendosja e detyrimeve konkrete për të gjithë subjektet që shfrytëzojnë sipërfaqet e fondit pyjor për zhvillimin e veprimtarive të tjera ekonomike për të pyllëzuar në raportin 1 me 3 për çdo dru të prerë dhe në raportin 1 me 2 për sipërfaqet kullosore, etj.

Natyrisht moratoriumi nuk mund të realizohet 100% në praktikë për vetë arsyen se nevoja e popullsisë për lëndë drusore për ngrohje, nevoja e vetë pyllit për t'u pastruar dhe nevojat e shtetit për tjetërsim prone nuk mund të anashkalohen.

III. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i hartuar duke patur parasysh teknikën legjislative dhe ka në total 9 nene, në të cilat përcaktohen qëllimi, objekti dhe fusha e zbatimit të ligjit, përjashtimet nga fusha e zbatimit, të drejtat ekzistuese të fituara me anë të prokurimit publik për shfrytëzimin e fondit pyjor, afati i zbatimit, sanksionet institucionet që ngarkohen me zbatimin e tij dhe aktet ligjore që duhet të dalin për këtë ligj duke përcaktuar edhe afatin kur Këshilli i Ministrave duhet t'i miratojë ato.

Projektligji i propozuar ka për qëllim të reduktojë ndërhyrjet mbi fondin pyjor, të degraduar si pasojë e mbi shfrytëzimit dhe dëmtive të tjera, me synim përmirësimin dhe rehabilitimin e gjendjes së tij.

Objekti i këtij ligji është ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së shfrytëzimit të lëndës drusore në fondin pyjor publik/privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, tregtimi i produkteve të tij, ndalimi i eksportit të lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, drurëve të zjarrit si dhe i qymyrit të drurit.

Si pasojë e nevojës për lëndë drusore dhe për vzhillimin e infrastrukturës së vëndit, ishte e domosdoshme që të përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij ligji:

- a) shfrytëzimi i lëndës drusore për plotësimin e nevojave të banorëve të bashkive për dru zjarri;
- b) rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor dhe kullosor referuar legjislacionit në fuqi;
- c) shfrytëzimi i lëndës drusore për rigjenerimin, shëndetësimin e pyjeve dhe pastrimin e mbetjeve drusore.

Kriteret dhe procedurat për të cilat do të përcakton me vendim të Këshillit të Ministrave.

Afati i zbatimit të këtij ligji, pra i vetë moratoriumit të shfrytëzimit është 10 (dhjetë) vjet nga data e hyrjes të tij në fuqi. Akti gjithashtu parashikon edhe sanksione mjaft të rënda për kundërvajtësit e këtij ligji që shkojnë në gjobë, në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

IV. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Ministria përgjegjëse për pyjet, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Financës dhe bashkitë.